

20070720913

L I G J
PËR THEMELIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE NË BUJQËSI
DHE ZHVILLIMIN RURAL

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen themelimi, kompetencat, organizimi dhe mënyra e kryerjes së punëve dhe udhëheqjes me Agjencinë për mbështetjen financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural, dhe përcaktohen burimet për sigurimin e mjeteve për financimin e punës së Agjencisë dhe dedikimin e tyre, si dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë dhe rajoneve rurale.

Qëllimi i Ligjit

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është që të sigurohet:

- zbatimi i politikës bujqësore dhe mbështetja e zhvillimit rural në Republikën e Maqedonisë,
- shfrytëzimi i mjeteve nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian për zhvillimin rural, në pajtim me kriteret e përcaktuara në marrëveshjet bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian,
- zbatimi i politikës së përbashkët bujqësore të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë,
- zbatimi i politikës së përbashkët të peshkimit të Unionit Evropian në Republikën e Maqedonisë,
- zbatimi i masave të ndihmës shtetërore në bujqësi, dhe
- zbatimi i masave të tjera që i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Qëllimet e këtij ligji realizohen përmes programeve, që në pajtim me ligjin i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Statusi i Agjencisë

Neni 3

Agjencia për mbështetjen financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e mëtejme: Agjencia), themelohet si organ i pavarur i administratës shtetërore, me cilësinë e personit juridik.

Emri i plotë i Agjencisë është: Agjencia për mbështetjen financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Selia e Agjencisë është në Shkup.

Akreditimi për shfrytëzimin e mjeteve
nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian

Neni 4

Për shfrytëzimin e mjeteve nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian, Agjencia merr akreditim nga Koordinatori nacional për autorizim dhe nga Komisioni Evropian.

Koordinator nacional për autorizim sipas këtij ligji, është personi i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Mënyrën dhe procedurën për marrjen e akreditimit nga Koordinatori nacional për autorizim, më afërsisht i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, ndërsa mënyra dhe procedura për marrjen e akreditimit nga Komisioni Evropian, rregullohet me marrëveshje bilaterale të lidhura ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian.

Parimet për kryerjen e punëve

Neni 5

Punët nga kompetenca e vet, Agjencia i kryen në bazë të parimeve të ligjshmërisë, specialitetit, profesionalizmit, përgjegjësisë, efikasitetit dhe transparencës.

II. KOMPETENCAT E AGJENCISË

Kompetenca

Neni 6

Agjencia është kompetente për:

- zbatimin e masave për pagesat e drejtpërdrejta në bujqësi,
- intervenimet në tregun e prodhimeve bujqësore,
- implementimin e kuotave prodhuese,
- zbatimin e masave për zhvillimin rural,
- realizimin e mjeteve nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian,
- zbatimin e masave të ndihmës shtetërore në bujqësi, dhe
- kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me ligj.

Punët e Agjencisë

Neni 7

Për realizimin e kompetencave nga neni 6 i këtij ligji, Agjencia i kryen punët si vijojnë:

- pranimin, evidentimin dhe përpunimin e kërkesave për mbështetje financiare,
- lejjimin e pagesës së mjeteve,
- organizimin e funksioneve financiare, të kontabilitetit dhe për njoftim, që kanë të bëjnë me pagesat në pajtim me këtë ligj,
- revizionin e brendshëm,
- organizimin, realizimin dhe koordinimin e kontrolleve administrative dhe teknike dhe kontrolleve aty për aty,
- grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave,
- udhëheqjen e bazës së të dhënave dhe regjistrave, dhe
- përgatitjen e raporteve dhe analizave.

Kryerja e punëve me marrëveshje

Neni 8

Përveç për punët e përcaktuara në nenin 7, alineja 3 e këtij ligji, për kryerjen e punëve të caktuara nga kompetenca e Agjencisë që kërkojnë profesionalizëm të veçantë dhe për realizimin e të cilave nevojiten persona përkatës profesionalë, pajisje dhe aparate që nuk i posedon Agjencia, Agjencia mund të lidhë marrëveshje për bashkëpunim me organin tjetër të administratës shtetërore, institucionin publik ose personin tjetër juridik.

Agjencia rregullisht e bën kontrollin e kryerjes së punëve të kontraktuara, me qëllim që të konfirmojë nëse kryerja e të njëjtave i plotëson standardet e përcaktuara me marrëveshjen për bashkëpunim, nga paragrafi 1 i këtij neni.

Agjencia mbetet përgjegjëse për pagesën e ligjshme dhe kryerjen efikase të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni.

III. FINANCIMI I PUNËS SË AGJENCISË

Burimet e mjeteve

Neni 9

Mjetet për financimi e punës së Agjencisë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Përveç mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni, puna e Agjencisë mund të financohet edhe me mjete nga burimet e tjera të përcaktuara me ligj, si dhe nga Buxheti i Unionit Evropian, në pajtim me kriteret e përcaktuara në marrëveshjet bilaterale, të lidhura ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian.

Agjencia siguron mjete për kryerjen e punëve nga neni 8, paragrafi 1 i këtij ligji.

Mënyra e pagesës së mjeteve

Neni 10

Pagesa e mjeteve për dedikimet nga neni 2, alinea 1, 5 dhe 6 të këtij ligji, do të kryhet në pajtim me legjislaturën e Republikës së Maqedonisë.

Pagesa e mjeteve për dedikimet nga neni 2, alinea 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, do të kryhet në pajtim me legjislaturën e Republikës së Maqedonisë dhe legjislaturën e Unionit Evropian.

IV. UDHËHEQJA ME AGJENCINË

Drejtori

Neni 11

Me Agjencinë udhëheq drejtori.

Drejtorin e Agjencisë e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Emërimi i drejtorit kryhet në bazë të profesionalizmit dhe kompetencës së tij.

Mandati i drejtorit zgjat katër vjet.

Kompetencat

Neni 12

Drejtori i Agjencisë i kryen punët si vijojnë:

- udhëheq me punën e Agjencisë,
- kujdeset dhe është përgjegjës për kryerjen e ligjshme, profesionale dhe efikase të punëve nga kompetenca e Agjencisë,
- e organizon dhe kontrollon punën e Agjencisë, në mënyrën me të cilën mbrohen interesat financiare të Republikës së Maqedonisë dhe interesat financiare të Unionit Evropian, në aspektin e shfrytëzimit të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe Buxheti i Unionit Evropian,
- i miraton aktet për organizimin dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të Agjencisë,
- e miraton planin financiar vjetor dhe për më shumë vite,
- e miraton planin strategjik dhe programin vjetor për punë, dhe e organizon zbatimin e tij,
- miraton akte të tjera lidhur me punën e Agjencisë (rregullore, doracakë, plane, udhëzime, aktvendime etj.),
- vendos për punësimin, sistemimin dhe për të drejtat dhe obligimet e të punësuarve,
- e miraton llogarinë vjetore financiare të Agjencisë,
- kujdeset për pavarësinë dhe efikasitetin e revizionit të brendshëm,
- kujdeset për zbatimin e përpiktë të akteve interne të Agjencisë, dhe procedurave për marrjen e akreditimit nga neni 4 i këtij ligji,
- vendos në procedurën administrative të shkallës së parë,
- e vendos sistemin përkatës të informimit, përmes të cilit Koordinatorin nacional për autorizim merr vërtetim për funksionimin efektiv të udhëheqjes dhe kontrolleve në Agjenci, vërtetim për ligjshmërinë e transaksioneve dhe informatave financiare që kanë të bëjnë me çfarëdo ndryshimi në mënyrën e punës së Agjencisë, ndryshimin e mënyrës së kryerjes së kontrolleve dhe ndryshimin e elementeve të informatave të kontabilitetit, dhe
- kryen punë të tjera lidhur me punën e Agjencisë.

Drejtori gjatë vendimmarrjes për punësim, duhet ta sigurojë përfaqësimin e drejtë dhe përkatës të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, pa i prishur me këtë rast kriteret për profesionalizëm dhe kompetencë.

Drejtori me autorizimin me shkrim mundet t'ua bartë kompetencat e tij të veçanta nëpunësve udhëheqës në Agjenci.

Formimi i ekipeve profesionale

Neni 13

Përveç për punët e përcaktuara në nenin 7 alineja 3 e këtij ligji, për kryerjen e punëve profesionale nga kompetenca e Agjencisë, drejtori mund të formojë ekipe profesionale, me pjesëmarrjen e personave të jashtëm profesionalë.

Përbërjen dhe numrin e anëtarëve të ekipeve profesionale, i përcakton drejtori i Agjencisë.

Përgjegjësia

Neni 14

Drejtori i Agjencisë për punën e tij mban përgjegjësi në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ndërsa lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian, mban përgjegjësi edhe para Koordinatorit nacional për autorizim.

Drejtori i Agjencisë për punën e tij dhe punën e Agjencisë, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, u paraqet raport gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e planeve dhe raport për punën materiale financiare, ndërsa lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga ndihma para hyrjes në Unionin Evropian, i paraqet raporte edhe Koordinatorit nacional për autorizim.

Shkarkimi

Neni 15

Drejtori i Agjencisë mund të shkarkohet para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar në rastet si vijon:

- me kërkesë të tij,
- nëse paraqitet ndonjë prej arsyeve për shkak të të cilave, sipas dispozitave për marrëdhënie pune, i pushon marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit dhe
- nuk vepron në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë dhe legjislacionin e Unionit Evropian.

V. ORGANIZIMI I AGJENCISË

Neni 16

Organizimin e brendshëm të Agjencisë e përcakton drejtori me aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave në pajtim me kompetencat e Agjencisë.

VI. PROCEDURA PARA AGJENCISË

Procedura administrative

Neni 17

Në drejtim të marrjes së veprimeve në procedurën administrative në Agjenci veprohet në pajtim me këtë ligj, ndërsa për gjithçka që nuk është e rregulluar me këtë ligj zbatohen dispozitat nga Ligji për procedurën e përgjithshme administrative.

Afati për marrjen e vendimit

Neni 18

Në lidhje me kërkesat e pranuar për përkrahje financiare, Agjencia lëshon vendim të cilin ia dorëzon palës më së voni në afat prej tre muajve nga dita e marrjes së kërkesës.

Për shkak të gjatësisë dhe kompleksitetit të kryerjes së kontrolleve gjatë realizimit të masave të veçanta, nëse ajo është e lejuar me programet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Agjencia mund ta lëshojë vendimin edhe pas afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, por i njëjti nuk mund të jetë më i gjatë se afati i përcaktuar për pagesën e mjeteve financiare të theksuar në programet.

Afati i refuzimit të kërkesës jo të plotë dhe të pakuptueshme

Neni 19

Nëse kërkesa është jo e plotë ose e pakuptueshme, Agjencia do ta detyrojë paraqitësin që në afat të caktuar ta plotësojë ose sqarojë kërkesën.

Kërkesa do të konsiderohet se është dorëzuar në rregull nga dita kur është dorëzuar ose sqaruar plotësimi i saj.

Plotësimin ose sqarimin e kërkesës, paraqitësi i kërkesës e dorëzon më së voni deri në afatin e fundit të caktuar në programin adekuat.

Ankesa ndaj vendimit

Neni 20

Kundër vendimit të Agjencisë, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit në Komisionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendosje në procedurë administrative në shkallë të dytë nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, ekonomisë së ujërave dhe veterinarisë.

Ankesa nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Shfuqizimi i vendimit të marrë

Neni 21

Kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë jo të drejtë ose është zbatuar gabimisht dispozita materiale dhe palës i është lëshuar vendim, Agjencia, në afat prej tre muajve nga dita e dorëzimit të vendimit palës, mund ta shfuqizojë të njëjtin dhe ta zëvendësojë me vendim të ri.

Anulimi dhe shfuqizimi i vendimit

Neni 22

Vendimi me të drejtë mbikëqyrjeje mund të anulohet ose të shfuqizohet në afat prej pesë vjetëve nga marrja e tij, nëse me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë ose me legjislacionin e Unionit Evropian është përcaktuar kthimi i detyrueshëm i mjeteve, respektivisht kur me vendim janë lejuar më shumë mjete ose mjetet u janë paguar gabimisht shfrytëzuesve të caktuar.

Pala e pakënaqur ndaj aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqesë ankesë në pajtim me nenin 20 të këtij ligji.

Përtëritja e procedurës

Neni 23

Procedura e cila është përmbyllur me vendim, respektivisht për të cilën në procedurën administrative nuk mund të dorëzohet mjet i rregullt juridik, ndërsa vendimi ka qenë i marrë në bazë të të dhënave jo të sakta, mund të përtëritet në afat prej pesë vjetëve nga marrja e vendimit.

Barazimi dhe kthimi i mjeteve të paguara në mënyrë jo të rregullt

Neni 24

Mjetet të cilat pala është e detyruar t'i kthejë në bazë të vendimit ekzekutiv, Agjencia mund t'i barazojë me mjetet që palës ende nuk i janë paguar në çfarëdo baze nga ky ligj.

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ka të bëjë me mjetet nga neni 6, alinetë 4 dhe 5 të këtij ligji.

VII. PROCEDURA PËR LEJIMIN DHE DESTINIMIN E MJETEVE

Dorëzimi i kërkesës

Neni 25

Kërkesa dhe dokumentacioni adekuat për përkrahjen financiare dorëzohet në Agjenci.

Kërkesat për përkrahjen financiare dhe dokumentet adekuate dorëzohen dhe përpunohen në pajtim me aktet për punë të Agjencisë.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni dhe dokumentacionin adekuat, si dhe mënyrën dhe procedurën për dorëzimin e kërkesës i përcakton drejtori i Agjencisë.

Procedura për punë

Neni 26

Drejtori i Agjencisë i përcakton procedurat detale për zbatimin e punëve nga neni 7 i këtij ligji.

Destinimi i mjeteve

Neni 27

Mjetet e siguruara në pajtim me nenin 9 të këtij ligji do të shfrytëzohen për realizimin e kompetencave dhe punëve të Agjencisë nga neni 6 dhe neni 7 i këtij ligji.

VIII. TRANSPARENCA NË PUNË

Mënyra e informimit

Neni 28

Agjencia për aktivitetet e veta i informon subjektet e interesuar në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

Shfrytëzimi i të dhënave dhe shikimi në shkresat

Neni 29

Palët në procedurën e Agjencisë kanë të drejtën për shikim në shkresat e lëndës së tyre.

Kërkesa për shikim në shkresa paraqitet në formë të shkruar, kurse e lejon personi i autorizuar, nëpunës i Agjencisë.

IX. KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 30

Drejtori dhe të punësuarit e Agjencisë nuk guxojnë të marrin pjesë në marrjen e vendimeve, nëse objektiviteti i tyre është vënë në pyetje për shkak të ekzistimit të interesit të përbashkët, konflikt të interesave ose janë në lidhje familjare në linjë të drejtë dhe në linjë anësore deri në brezin e katërt, adoptuesi dhe i adoptuari, farefisni sipas krushqisë deri në brezin e dytë me kërkuesin për shfrytëzim të mjeteve sipas këtij ligji.

Nëse personat nga paragrafi 1 i këtij neni e heshtin ekzistimin e interesit të përbashkët, gjykata kompetente, me kërkesë të palës së interesuar mund ta anulojë marrëveshjen ose punën tjetër juridike.

X. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË

Neni 31

Agjencia realizon bashkëpunim me organet e administratës shtetërore, institucionet shkencore, organizatat ndërkombëtare dhe asociacionet tjera që janë me rëndësi për kryerjen e punëve në kompetencë të Agjencisë.

XI. KONTROLLI I PUNËS SË AGJENCISË

Mbikëqyrja

Neni 32

Mbikëqyrjen e punës së Agjencisë e bën Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mbikëqyrjen e punës së Agjencisë në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve për ndihmë para hyrjes për zhvillim rural të Unionit Evropian e bën edhe Koordinatorin nacional për autorizim.

Kontrolli i brendshëm

Neni 33

Drejtori i Agjencisë është i detyruar të vendosë kontroll të brendshëm nëpërmjet implementimit të sistemit adekuat të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe revizion të brendshëm në pajtim me Ligjin për kontroll të brendshëm financiar transparent.

Revizioni

Neni 34

Revizioni i punës materiale dhe financiare i Agjencisë bëhet në pajtim:

- me legjislacionin për revizion të Republikës së Maqedonisë dhe
- me legjislacionin për revizion të Unionit Evropian në pjesën e realizimit të mjeteve nga Buxheti i Unionit Evropian.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Dispozitat nga neni 2, alinetë 3 dhe 4 do të zbatohen pas pranimin të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

Neni 36

Dispozitat nga neni 10, paragrafi 2, neni 15, alineja 3, neni 22 dhe neni 34, alineja 2 nga ky ligj që udhëzojnë në zbatimin e legjislaturës së Unionit Evropian do të zbatohen në pajtim me marrëveshjet bilaterale të lidhura midis Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.